



## **KËSHILLI BASHKIAK**

### **V E N D I M**

Nr. 62, datë 06.06.2017

**“PËR DHËNIEN E PËLQIMIT MBI VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1069, DATË 23.12.2015” “PËR TJETËRSIMIN E PRONËSISË SHTETËRORE “TRUALL” NGA PRONË SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE, PËR SHOQËRINË “BLOJA” SH.P.K, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 122, DATË 05.03.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA E MADHE E TIRANËS “KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS)”.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/ 1.1 shkronja (b) dhe pikës 1/1.2; nenit 23 pika 6, nenit 54/k) dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/ 2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1069, datë 23.12.2015 “Për tjetërsimin e pronës shtetërore “truall”, nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja”, shpk, Tiranë dhe për një ndryshim në Vendimin Nr. 122, datë 05.03.2014 të Këshilli të Ministrave “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës (Komuna e Parisit rruga e Kavajës)”” dhe shkresën me nr. Prot. 7840/2, datë 28.02.2017 me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

### **V E N D O S I:**

1. Të japë pëlqimin e Bashkisë së Tiranës për vazhdimin e procedurës të parashikuar në Vendimin Nr. 1069, datë 23.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për tjetërsimin e pronës shtetërore “truall” nga pronë shtetërore në pronë private, për shoqërinë “Bloja” sh.p.k, Tiranë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 122, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe e Tiranës “Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës)”.
2. Shkëmbimi i pasurisë së parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe çdo procedurë tjetër e nevojshme për realizimin e këtij transaksioni të kryhet sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**